




REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të dates 4 qershor 2008, Rregullores MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të dates 26.09.2008, duke u bazuar në Aktin-Listën e publikuar për shpalljen e përfituesve për ndarjen e subvencioneve për OJQ-të rinore dhe kulturore 5Nr.400-34037 të datës 23.06.2021, Listës përfundimtare të komisionit vlerësues Nr.1-400-36802 të datës 06.07.2021, Kryetari i Komunes, nxjerr këtë:

**V E N D I M**  
**PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR OJQ -TË RINORE DHE KULTURORE**  
**PËR VITIN 2021**

**Neni 1**

1. Ndahet shuma e mjeteve në vlerë prej **12,585.00 €** (dymbëdhjetmijë e pesëqind e tetëdhjetë e pesë euro), për t'i mbështetur financiarisht OJQ-të rinore dhe kulturore të Komunës së Lipjanit për zhvillimin e aktiviteteve të tyre për vitin 2021, të cilët kanë aplikuar sipas Thirrjes publike për aplikim Nr.1-400-19370 e datës 14.04.2021, ku gjithë procedura që nga shpallja publike e deri në nxerrjen e këtij Vendimi është zhvilluar konform dispozitave të Rregullores MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.
2. Në tabelën vijuese janë OJQ-të përfituese të cilat do të mbështeten financiarisht nga Komuna për vitin 2021

Nr.	Emërtimi i OJQ-ve	Shuma
1.	OJQ "Vizioni Rinor Janjevë" - Lipjan	1,380.00 €
2.	OJQ "TARC"	1,310.00 €
3.	OJQ "YOUTH Center Lyc" - Lipjan	1,270.00 €
4.	OJQ "Instiuti për paqe dhe bashkëpunim"	1,260.00 €
5.	OJQ "Vizioni Rinor Shalë"	1,095.00 €
6.	OJQ "KVRL"	1,070.00 €
7.	OJQ "ZPAN"	1,070.00 €
8.	OJQ "Instituti për Fuqizim dhe Pjesëmarrje në Vendimmarrje për Rini"	1,060.00 €
9.	OJQ "Youth Conection" - Lipjan	1,050.00 €
10.	OJQ "Jeta Rinore"	1,010.00 €
11.	OJQ "Sveti Sava"	1,010.00 €
	Shuma Totale	<b>12,585.00 €</b>

## Neni 2

Shuma e cekur në nenin 1 të këtij Vendimi do të paguhet nga kategoria e subvencioneve të planifikuara për vitin 2021 të Drejtoratit për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Zyrës së Kryetarit të Komunës.

## Neni 3

Të drejtat dhe obligimet në mes të komunës dhe klubeve sportive do të rregullohen në Kontratat të cilat do të lidhen në mes të Kryetarit të Komunës dhe seciles OJQ veq e veq.

## Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

1Nr.400-36802

Lipjan, më 07.07.2021

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti

